



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	10-02	Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No.	8280-2/25
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	-03-	Data. Datum. Date.	22,04/2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	08.04.2026
REFERENC-Ë:	25/8280/709/DMM
PËR/ZA/TO:	"Arberi EB" Sh.p.k. Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/8280/709/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Refuzimin** e kërkesës së Kompanisë "Arberi EB" Sh.p.k. Gjakovë, për të u pajisur me Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorit në ngastrat kadastrale P-70705048-00394-5; P-70705084-00394-7 dhe P-70705084-00398-2 në Z.K. Shishman, Komuna e Gjakovës.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Refuzimin e kërkesës së Kompanisë "Arberi EB" Sh.p.k. Gjakovë, për të u pajisur me Pëlqim Mjedisor për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorit në ngastrat kadastrale P-70705048-00394-5; P-70705084-00394-7 dhe P-70705084-00398-2 në Z.K. Shishman, Komuna e Gjakovës.

A r s y e t i m

Në takimin e komisionit, pas mbajtjes së debatit publik, komisioni ka hasur se në informatën e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Njoftimin mbi Ekstakt, me nr. prot. 07-351/03-64093, të datës 17.12.2025 sipas HZK 2024-2032, ku zhvillimi i veprimtarisë së tillë bie në kategorinë e tokave bujqësore dhe bazuar në dokumentin në fjalë dhe në Ligjin për Tokën Bujqësore konsiderohet tokë intenzive bujqësore që duhet mbrojtur në mënyrë të rreptë për shfrytëzim bujqësor, andaj një kërkesë e tillë bie në kundërshtim me Njoftimin mbi Ekstakt.

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Bazuar në të lartcekuat dhe në propozimin e Komisionit për VNM, Sekretari i Përgjithshëm i MMPH merr vendim për **Refuzimin** e kërkesës për pajisje me Pëlqim Mjedisor të Kompanisë "Arbri EB" Sh.p.k. Gjakovë, për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorit në ngastrat kadastrale P-70705048-00394-5; P-70705084-00394-7 dhe P-70705084-00398-2 në Z.K. Shishman, Komuna e Gjakovës.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Vërejtje: Afati për shqyrtimin e lëndës është tejkaluar për shkak të kompleksitetit të lëndës dhe zëvendësimit të Sekretarit të MMPH-së.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/8280/- ZSP/ /26 datë: 08.04.2026

Prishtinë



Bajram Kafexholli

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Gjakovës
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPHI

Faqe 3 nga 3